



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Në vijim të kërkesës suaj, ju përcjellim informacionin e kërkuar mbi administrimin dhe menaxhimin e hapësirave publike në territorin e Bashkisë Shkodër.

- Bashkia Shkodër ka për qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike. Nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe strukturave përgjegjëse të Bashkisë Shkodër, qëllim është disponimi racional i burimeve të përbashkëta.
- Drejtoritë përgjegjëse për çështje që lidhen me hapësirat publike janë Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (e cila përgjigjet për planifikimin urban dhe miraton ndërhyrjet që prekin hapësirat publike), Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (e cila administron tarifat që lidhen me përdorimin e përkohshëm të hapësirave publike), Administratorët e Lagjeve (monitorojnë gjendjen në territor dhe raportojnë nevojat e komunitetit) dhe Policia Bashkiake (e cila siguron zbatimin e rregulloreve vendore dhe parandalon zënien e paligjshme të hapësirave publike).
- Ju vëmë në dijeni se Rregullorja e Përdorimit të hapësirës publike është miratuar me vendimin nr. 45, datë 25.06.2025 të Këshillit Bashkiak Shkodër, e cila ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara të përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë Shkodër. Rregulloren mund ta gjeni në faqen zyrtare të bashkisë Shkodër.

Për çdo informacion shtesë, mbetemi në kontakt.

K R Y E T A R

Benet BECI